



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2024:180643  
Datë: 27.08.2024  
Numri i dokumentit: 06089148

P.nr.293/24

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Benita Berisha, me zyrtarin ligjor Besart Mustafa, në çështjen penale ndaj të pandehurave: Sh.M.dhe F.B., për shkak të veprës penale secila veç e veç Sulmi nga neni 184 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1049/24 të datës 08.08.2024 dhe kërkesës për shqiptimin e Urdhrit Ndëshkimor, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, jashtë seancës, me datë 27.08.2024, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

PRANOHET Kërkesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1049/24 të datës 08.08.2024 dhe kjo Gjykatë konform dispozitës të nenit 495 të KPP-së, jep këtë:

### URDHËR NDËSHKIMOR

#### Të pandehurat:

- I. Sh.M., nga e ati Sh....., e ëma M..., e vajzërisë B....., e lindur me datë ....., në Mitrovicë, ku edhe jeton rr. “.....”, pn, me numër personal ....., e martuar, prind i katër fëmijëve, e pa punësuar, ka të kryer shkollën fillore, e gjendjes së mirë ekonomike, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës.
- II. F..... B.... me nofëkn “F....”, nga i ati I....., e ëma V..., e vajzërisë S....., e lindur me datë ....., në L....., me vendbanim në Mitrovicë, rr. ‘.....’, p.n., me numër personal ....., e martuar, e punësuar në ....., me profesion juriste, ka të kryer Fakultetin Juridik, e gjendjes së mirë ekonomike, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës.

### JANË FAJTORE

#### SEPSE:

Me datë ....., rreth orës ....., në Mitrovicë, në rrugën ‘.....’, përkatësisht në bodrumin e banesës, të pandehurat me dashje kanë përdorë forcën ndaj njëra tjetrës, në atë mënyrë që për shkaqe xhelozie, të njëjtat sulmojnë fizikisht njëra tjetrën edhe atë e pandehura Sh.... e kapë për flokë dhe për bluze F... si dhe e shtynë me duar, përderisa e pandehura F.... e kapë për fyti Shpresën dhe në të njëjtën kohë e godet me grusht me ç’rast ndërhyjnë dëshmitarja Rr.... R.... e cila arrin që ti ndajë.

**Me këtë secila veç e veç ka kryer veprën penale Sulmi nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata në bazë të dispozitave të neneve: 1, 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69 dhe 184 par. 1 të KPRK-së, si dhe neneve: 364, 449, 452, 462 dhe 495 të KPP-së, i :

## **G J Y K O N**

Të pandehurës Sh... M....., i shqipton;

- I. DËNIM ME GJOBË në shumë prej 400 € (*katërqind euro*), të cilin dënim është e obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse e pandehura nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, Gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43 par.3 të KPRK-së, ashtu që dënimin me gjobë do t'ia zëvendësoj me dënim me burgim, duke i llogaritur për çdo 20 € (njëzet euro) gjobë me një (1) ditë burgim.
  - E dëmtuara F.B., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Të pandehurës F.B., i shqipton;

- II. DËNIM ME GJOBË në shumë prej 400 € (*katërqind euro*), të cilin dënim është e obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse e pandehura nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, Gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43 par.3 të KPRK-së, ashtu që dënimin me gjobë do t'ia zëvendësoj me dënim me burgim, duke i llogaritur për çdo 20 € (njëzet euro) gjobë me një (1) ditë burgim.
  - E dëmtuara Sh.... M....., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.
- III. Obligohen të pandehurat secila veç e veç që në emër të shpenzimeve procedurale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 20€ (njëzet euro), në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20€ (njëzet euro), ndërsa në emër të ekspertizës mjeko-ligjore në mënyrë solidarë obligohen të paguajnë shumën prej 20€ (njëzet euro), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.1049/24 të datës 08.08.2024, kundër të pandehurave Sh.M.dhe F.B. për shkak të veprës penale: secila veç e veç Sulmi nga neni 184 par. 1 të KPRK-së, dhe njëherësh, nga Gjykata ka kërkuar dhënien e Urdhrit Ndëshkimor-Dënim me gjobë, me arsyetimin se ka prova të besueshme nga kallëzimi penal dhe provat e propozuara lidhur me arsyeshmërinë e aktakuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve se të pandehurat vërtetë e kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen.

Gjykata, me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, gjeti se aktakuza dhe kërkesa janë të bazuara dhe se janë plotësuar kushtet nga neni 493 i KPP-së, që të pranohet kërkesa për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe në përputhje me nenin 495 të KPP-së të jepet aktgjykimi pa u mbajtur shqyrtimi gjyqësor, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që në shkresat e lëndës ka prova të mjaftueshme në bazë të cilave vërtetohet se të pandehurat e kanë kryer veprën penale e cila iu vihet në barrë.

Me dispozitat ligjore të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), për veprën penale Sulmi nga neni 184 par. 1 të KPRK-së me të cilën akuzohen të pandehurat, ligjvënësi ka parashikuar dënimin me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit, që nënkupton se në rastin konkret zbatohen dispozitat ligjore të procedurës së veçantë nga neni 495 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPP).

Gjykata, konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës dhe atë: Akt ekspertimi mjeko ligjor me numër reference .. i datës ....., Raporti i oficerit, i datës ....., Fotografitë-fotoalbumi, Procesverbali i marrjes në pyetje të dëshmitares Ad.... M.... në polici i datës ....., Procesverbali i marrjes në pyetje të dëshmitares Rr.... R.... në polici i datës ....., Procesverbalet e marrjes në pyetje për të pandehurat në polici të datës ....., si dhe shkresat e tjera të lëndës, janë prova të mjaftueshme mbi bazën e të cilave vërtetohet se në veprimet e të pandehurave manifestohen elementet e veprës penale e cila u vihet në barrë, për këtë edhe iu shqiptoi urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit me gjobë, konform nenit 69 të KPRK-së, gjykata ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në matjen e dënimit, duke konsideruar se dënimi i është në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale meqë rast vepra penale është kryer me dashje nga ana e të pandehurve, me intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur në këtë çështje penale dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale.

Andaj, gjykata vlerëson se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit, i cili parashihet me nenin 38 të KPRK-së, që të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor dhe ekspertizës, u mor në bazë të nenit 449 par. 2 nën par. 2.1 dhe 2.6 lidhur me par.1 dhe nenit 452 par. 1 të KPP-së. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 par. 3 nën. par 3.1 të Ligjit nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimin lidhur me kërkesën pasurore juridike, gjykata e mori konform nenin 462 par.1 dhe 2 të KPP-së.

Nga sa u tha më lartë, konform neneve 364 dhe 495 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal**  
**P.nr.293/24, datë :27.08.2024**

**Zyrtari Ligjor**  
**Besart Mustafa**

**G j y q t a r j a**  
**Benita Berisha**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi të pandehurat ose mbrojtësit e tyre mund të paraqesin kundërshtim, në afat prej 8 (tetë) ditëve, nga dita e pranimit të tij. Kundërshtimi i parashtrohet kësaj Gjykate.